

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Dorëzimi / *et-Teslim* / التَّسْلِيم

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

"قَالَ رَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ حَتَّىٰ يُحَكِّمُوكَ فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ لَا يَجِدُوا فِي أَنفُسِهِمْ
حَرَجًا مِّمَّا قَضَيْتَ وَيُسَلِّمُوا تَسْلِيمًا"

"Por, jo, pasha Zotin tënd, ata s'do të besojnë njëmend, derisa të bëjnë ty (O Muhamed) gjykatës në mosmarrëveshjet mes tyre dhe më pas të mos ndiejnë bezdi për gjykimin tënd dhe të nënshtrohen krejtësisht (me vullnetin e tyre)." (en-Nisa, 65)

Dorëzimi (*teslim*) ndaj Zotit ka po të njëjtat njolla si të lënies së çështjes në dorë të Allahut (*tewfiid*) dhe të mbështetjes te Ai (*tewekkul*)¹. Kjo është shkalla më e lartë e besimtarëve të rëndomtë² dhe ka tri nivele:

Niveli i parë:

- Heqja dorë nga të gjitha hamendjet e rrëmujshme paragjyquese për të padukshmen³
- Nënshtrim ndaj caktimeve që bien ndesh me supozimet logjike lidhur me ndryshimin e gjendjeve dhe ndarjeve të hiseve⁴

¹ Vetë mendimi yt se ti posedon ndonjë gjë për t'i lë në dorë Allahut apo për t'i lënë në dorëzim Atij është njolla më e madhe.

² Imam Ibn el-Kajjim shpjegon në *Medaarixh* sesi dorëzimi i njëmendtë është shkalla më e lartë e elitës së besimtarëve. Ka mundësi që dorëzimi - siç mendohet nga shumica e besimtarëve - është ai, që Imam el-Harawi konsideron ta ketë tejkuluar elita e besimtarëve. Po ashtu ka mundësi që Imam el-Harawi i konsideron të paplotësuar të gjitha shkallët ku s'është arritur *fanaa* (vetasgjësimi; asgjësimi i egos).

³ Kur hamendjet e tua paragjyquese për të padukshmen bëjnë rrëmujë në mendjen tënde dhe pengojnë reformimin e saj nga ana e Shpalljes.

- Angazhimi në rrethana e gjendje që janë të frikshme për ndjekësin⁵

Niveli i dytë:

- T'ia dorëzosh dijen gjendjes (sate shpirtërore)⁶
- T'ua dorëzosh qëllimet e paramenduara zbulimeve⁷
- T'ua dorëzosh format realiteteve⁸

Niveli i tretë:

- Të heqësh dorë nga të gjithë të tjerët për të Vërtetin
- ndërsa je i pastër nga të parët e aktit tënd të dorëzimit⁹,
- duke parë vetëm dorëzimin që ta bën i Vërteti tek Vetja e Tij¹⁰

⁴ Kjo ka të bëjë me pranimin e caktimeve të Tij dhe moskundërshtimin e tyre, madje dhe të mos pyetesh veten për to. Kur të shohësh popujt të ngrihen e të bien; kur të shohësh ndryshimet në gjendjen tënde dhe në gjendjet e atyre që ke përreth; kur të shohësh shpërndarjen e furnizimeve, të pushtetit, të pozitave, përfshirë dhe ndarjet e gjendjeve shpirtërore në një mënyrë që s'mund të kuptohen, dorëzoju urtësisë së Tij.

⁵ Me një ushtri prej tre mijë ushtarësh, të furnizuar pak në krahasim me armiqtë e tyre, Sahabët iu përgjigjën urdhrit të Allahut dhe marshuan për t'u konfrontuar me romakët. Nëse sheh se duhet ta ndërpresësh punën apo ta lëshosh vendlindjen dhe shejtani të frikëson me perspektivën e skamjes e të vështirësisë, kujto që dorëzimi yt ndaj Allahut kurrë nuk të çon në shkatërrim. Kjo, po ashtu, mund të nënkuptojë kalimin nga një gjendje shpirtërore në tjetrën, siç kërkohet nga Allahu.

⁶ Imam Ibn el-Kajjim tërheq vërejtjen se shejhu (el-Harawi) vlerësohet të jetë mbi atë që disa gabimisht kuptojnë nga kjo thënie. Ai kurrë s'do ta kishte për qëllim ta lejonte gjendjen vetjake të jetë një gjykatës i dijes së Shpalljes. Ai kishte për qëllim se ka diçka përtej dijes, që është të vepruarit me të. Ka gjithashtu nevojë për vendosjen e dijes në kontekstin e duhur dhe zbatimin korrekt të saj. Të lësh dijen të kalojë nëpër një zemër të zgjuar është e domosdoshme për zbatimin e përshtatshëm të saj (dijes).

⁷ Nëse gjendesh në mes të rrugës sate dhe të tregohet një rrugë tjetër, merre atë, nëse ndihesh rehat me zbulimin që të bëhet dhe, natyrisht, nëse kjo nuk bie ndesh me Shpalljen. Zbulimi, po ashtu, mund të t'i shfaqë të metat e qëllimeve tua dhe të objektivave që ke.

⁸ Pamjet tona, veshjet, pozitat, gradat, etj., janë forma. Puna në të brendshmen tonë përcakton vlerën e veprimeve tona dhe shkallët tona të vërteta. Kjo po ashtu mund të nënkuptojë se, ai që sheh të vërtetën / të Vërtetin, nuk do të shohë forma a konstrukte para Tij.

⁹ Sepse të parët e dorëzimit (*teslim*) tënd do të thotë që, me veprimet e tua, të të hiqet vëmendja nga të parët e veprimeve të Tij.

¹⁰ Fundja, çfarë mund të bësh pa Të? Çfarë do të ishe pa Të? Hiçgjë!